

Raporti vjetor 2025-2026



Gjimnazi “Arben Broci” Tiranë

Mësuesja e lëndes: Brunilda Bozhano

Mentorja: Orjela Bajo

Përmbajtja

- Bordi drejtues
- Hyrje
- Misioni dhe vizioni
- Problemi, Zgjidhja, Klienti
- Produkti
- Prodhimi
- Marketing & Shitje
- Analiza e tregut
- Analiza SWAT
- Pasqyra Financiare dhe e ardhmja

Anex

- Letra e Presidentit
- Letra për vullnetarin
- Statuti i Shoqërisë

Bordi drejtues

- Joel Braho → Presidenti i kompanisë
- Diodor Ndoj → Drejtori i departamentit të marketingut
- Neviola Boci → Drejtorja e departamentit të burimeve njerëzore
- Nediol Rexhollari → Drejtori i departamentit të prodhimit
- Sidea Kello → Drejtorja e departamentit të financave

Hyrje

Në bujqësinë moderne, sfidat po bëhen gjithnjë e më të mëdha për shkak të ndryshimeve klimatike, mungesës së monitorimit të vazhdueshëm dhe dëmtimeve nga faktorë të jashtëm. Fermerët shpesh përballen me probleme si tharja e tokës, sëmundjet e bimëve dhe dëmtimet nga kafshët, pa pasur mundësi t'i identifikojnë në kohë reale. Kjo sjell humbje në prodhim dhe ulje të cilësisë së kulturave.

Në një botë ku teknologjia po zhvillohet me ritme të shpejta, lind nevoja për zgjidhje inteligjente që ndihmojnë fermerët të marrin vendime më të mira. Kështu lindi ideja e AgroVision X dhe produktit tonë GreenShield – një sistem që kombinon sensorë, kamerë dhe analizë të të dhënave për të monitoruar në mënyrë të vazhdueshme gjendjen e fermës.

Cilët jemi ne?

Ne jemi një grup të rinjsh të apasionuar pas teknologjisë dhe bujqësisë, që synojmë të sjellim inovacion në një sektor shumë të rëndësishëm për ekonominë. Qëllimi ynë është të ndihmojmë fermerët të rrisin efikasitetin dhe të ulin humbjet përmes përdorimit të teknologjive të thjeshta dhe të aksesueshme.

Përmes AgroVision X ne synojmë:

- Të ofrojmë zgjidhje praktike për problemet reale në bujqësi
- Të krijojmë produkte të lehta për përdorim dhe të përballueshme
- Të ndihmojmë fermerët të marrin vendime të bazuara në të dhëna
- Të kontribuojmë në modernizimin e sektorit bujqësor

Misioni

Misioni ynë është të ofrojmë një sistem të zgjuar monitorimi që ndihmon fermerët të kuptojnë më mirë gjendjen e bimëve, tokës dhe ambientit përreth. Ne synojmë të përmirësojmë produktivitetin bujqësor përmes përdorimit të teknologjisë, duke e bërë atë të thjeshtë dhe të përdorshme për çdo fermer.

Vizioni

Vizioni ynë është të bëhemi një kompani lider në fushën e teknologjisë bujqësore në Shqipëri dhe më gjerë. Synojmë të krijojmë një sistem të integruar që përdoret gjerësisht nga fermerët dhe bizneset bujqësore, duke kontribuar në një bujqësi më të zgjuar, më efikase dhe më të qëndrueshme.

Problemi

Në bujqësi, një nga sfidat kryesore është mungesa e monitorimit të vazhdueshëm të kushteve të bimëve dhe mjedisit. Shpesh fermerët mbështeten në vëzhgim manual dhe kontrole të herëpashershme, gjë që mund të çojë në vonesa në identifikimin e problemeve si mungesa e ujit në tokë, ndryshimet në temperaturë dhe lagështi, ose dëmtimet nga faktorë të jashtëm. Kjo ndikon direkt në cilësinë dhe sasinë e prodhimit.

Zgjidhja


GreenShield synon të ndihmojë përdoruesit të kenë një pamje më të plotë të kushteve në fermë duke bashkuar të dhënat mjedisore dhe vizuale në një platformë të vetme. Kjo i lejon përdoruesit të identifikojnë më shpejt ndryshimet në kushte dhe të marrin vendime më të informuara për ujitje, kujdesin e bimëve dhe menaxhimin e përgjithshëm të kulturave.

Klienti

Klientët e synuar janë fermerët, serrat bujqësore dhe bizneset e vogla e të mesme në sektorin e bujqësisë që kërkojnë mënyra më efikase për të menaxhuar kulturat e tyre. Gjithashtu, sistemi mund të jetë i dobishëm për individë që kultivojnë në mënyrë të organizuar dhe për struktura që kërkojnë monitorim më të saktë të kushteve të rritjes.

Produkti

GreenShield është një sistem monitorimi bujqësor që kombinon kamerë dhe sensorë për të mbledhur të dhëna mbi gjendjen e bimëve dhe mjedisit. Ai përdor sensorë për lagështinë e tokës, temperaturën dhe lagështinë e ajrit, ndërsa kamera shërben për vëzhgim vizual të bimëve dhe zonës përreth. Të dhënat mblidhen dhe paraqiten në një aplikacion për analizim dhe monitorim.



Prodhimi

GreenShield është ndërtuar duke përdorur një sistem të bazuar në Raspberry Pi 5 si njësia kryesore e përpunimit, e cila menaxhon të gjitha të dhënat nga kamerat dhe sensorët. Për mbledhjen dhe leximin e të dhënave nga sensorët e tokës dhe të ambientit është përdorur Arduino Uno, i cili komunikon më pas me Raspberry Pi përmes lidhjes seriale. E gjithë pajisja është programuar në Python, duke mundësuar integrimin e sensorëve, kamerës dhe sistemit të analizës në një platformë të vetme.


Për pjesën e inteligjencës artificiale, është trajnuar një model i dedikuar për analizimin e shëndetit të bimëve dhe identifikimin e anomalive. Ky model është trajnuar duke përdorur kombinim të databazave ekzistuese nga interneti dhe një seti imazhesh të mbledhura nga vetë sistemi gjatë testimeve. Kjo ka ndihmuar në përmirësimin e saktësisë së modelit në kushte reale të përdorimit.

Marketing


Marketingu ynë ka si qëllim edukimin dhe informimin e fermerëve për përfitimet e teknologjisë.

Strategjitë kryesore:

- Promovim në rrjetet sociale
- Website me përdorim të thjeshtë
- Reklama
- Bashkëpunime me kompani të tjera
- Sponsorizime



Shitja



GreenShield ofrohet si një produkt fizik që mund të blihet nga fermerët dhe bizneset bujqësore.

Produkti shitet përmes website-it tonë ose përmes bizneseve në bashkëpunim me ne.

Përveç pajisjes, përdoruesit përfitojnë edhe akses në aplikacionin ku paraqiten të gjitha të dhënat e mbledhura. Kjo e bën produktin një kombinim të harduerit dhe softuerit, duke rritur vlerën që merr klienti.


Shitja mund të realizohet në disa forma:

- Shitje direkte tek fermerët
- Prezantime dhe demonstrime në terren
- Bashkëpunime me biznese bujqësore dhe sera
- Promovim dhe porosi përmes rrjeteve sociale


Analiza e tregut

Këto janë disa pyetje që i kemi bërë 60 fermerëve


Cfarë vështirësish hasni gjatë rritjes së serave



A do ju hynte në punë një ndihmë monitorimi dhe analizimi?



A do blini produktin GreenShield?



Analiza SWAT

Strengths:

- Kombinim i teknologjisë me bujqësinë
- Monitorim në kohë reale
- Sistem i integruar dhe i automatizuar

Weaknesses:

- Produkt i ri në treg
- Kërkon njohuri bazë për instalim

Advantages:

- Rritje e kërkesës për teknologji bujqësore
- Mundësi zgjerimi në tregje të tjera

Threats:

- Konkurrencë nga produkte të huaja
- Kostot e zhvillimit dhe mirëmbajtjes

Financa

Shitja e aksioneve është realizuar me sukses, duke siguruar kapitalin fillestar për zhvillimin e produktit GreenShield. Kompania ka gjeneruar të ardhura nga shitja e produktit, duke krijuar një bazë fillestare financiare.

Të ardhurat dhe shpenzimet

Cmimi i produktit: 39,990 lekë

Tatimi: 1,460 lekë

Materialet (komponentë elektronikë, sensorë, pajisje): 16,000 lekë

Rrogat: 200 lekë për shitje

Shpenzime të tjera: 1,000 lekë

Totali i shpenzimeve:

$16,000 + 200 + 1,000 + 1,460 = 17,660$ lekë

Fitimi neto:

$39,990 - 17,660 = 22,330$

Bilanci financiar

Aktivet: 22,330 lekë

Tatimi: 1,460 lekë

Kapitali: 17,000 lekë

Totali: 39,330 lekë

Kapitali dhe aksionet

Kapitali total: 17,000 lekë

Fitimi neto: 22,330 lekë

Totali:

$17,000 + 22,330 = 39,330$ lekë

Nr. aksioneve: 85

Vlera për aksion: 200 lekë

E ardhmja

Në të ardhmen, synojmë të zgjerohemi në tregje të reja dhe të kontribuojmë në zhvillimin e bujqësisë së zgjuar. Qëllimi ynë është të krijojmë një sistem që bëhet pjesë e përditshme e çdo ferme moderne, duke ndihmuar në rritjen e prodhimit dhe mbrojtjen e burimeve natyrore.

Letra e Presidentit

Të dashur aksioner,
ky vit ka qenë një hap i rëndësishëm për AgroVision X. Ne kemi arritur të krijojmë një produkt funksional dhe të ndërtojmë një ekip të përkushtuar. GreenShield është rezultat i punës sonë dhe dëshirës për të sjellë inovacion në bujqësi. Ne do të vazhdojmë të zhvillohemi dhe të përmirësojmë produktin tonë. Faleminderit për mbështetjen tuaj.

Letra për vullnetarin

E dashur Orjela,

Me anë të kësaj letre dëshirojmë të shprehim mirënjohjen tonë të singertë për kontributin dhe mbështetjen tuaj si mentore gjatë zhvillimit të projektit tonë, AgroVision X dhe produktit GreenShield.

Angazhimi, përkushtimi dhe gatishmëria juaj për të ndarë njohuritë dhe përvojën kanë qenë një ndihmë shumë e vlefshme për ne. Falë udhëzimeve tuaja, kemi arritur të kuptojmë më mirë procesin e zhvillimit të një ideje, ta strukturojmë atë në mënyrë profesionale dhe ta çojmë përpara me më shumë siguri dhe motivim.

Ju falënderojmë për kohën, durimin dhe përkushtimin tuaj. Shpresojmë që bashkëpunime të tilla të vazhdojnë edhe në të ardhmen.

Me respekt dhe mirënjohje,
Ekipi i AgroVision X

Statuti i Shoqërisë

Emri: AgroVision X

Qëllimi: Zhvillimi i teknologjisë bujqësore

Struktura: E ndarë në departamente

Vendimmarrja: Nga drejtuesit

Fitimet: Ndahen sipas aksioneve

Aktiviteti: Në përputhje me ligjet në fuqi